



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORË  
SENATI AKADEMIK

Nr. 946 / Prot. 5

Vlorë më, 08 . 05 .2023

VENDIM  
Nr. 27, datë 08.052023

PER  
MIRATIMIN E KORRIGJIMIT TË PROVIMEVE NË FORMËN ELEKTRONIKE NË  
KUADËR TË IMPLEMENTIMIT TË PROJEKTIT CLEANSORE

Mbështetur në nenin 38 të Ligjit nr. 80/ 2015 "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë", nenin 19 të Statutit të Universitetit "Ismael Qemali", Vlorë, Vendimit nr.6, datë 24.04.2023 të Rektoratit si dhe referuar propozimit të Zv.Rektorit për Kërkimin Shkencor dhe Zhvillimin Institucional, me shkresë 733/2, prot datë 24.04.2023, Senati Akademik në mbledhjen e datës 08.05.2023,

VENDOSI:

1. Të miratojë në kuadër të marrëveshjes mes Universitetit "Ismael Qemali", Vlorë dhe Albanian-American Development Foundation (AADF), miratuar me Vendim të Senatit Akademik Nr.15, datë 31.03.2022, nr. 479/2 prot. datë 06.04.2022 "Për miratimin e nënshkrimit të marrëveshjes së bashkëpunimit midis Universitetit "Ismael Qemali", Vlorë dhe Albanian American Development Foundation(AADF), për implementimin e projektit Clean Score, korrigjimin alternativ të provimeve nëpërmjet përdorimit të sistemit të integruar teknologjik të CleanScore në vlerësimin e studentëve: "Në pikën 4 të nenit 89 të Rregullores së Brendshme të UV-së", të shtohet fjalia: " Departamentet përdorin edhe formën elektronike të vlerësimit të përgjigjeve të provimeve me shkrim, të studentëve, në lëndët dhe modulet e përcaktuara dhe miratuara prej tyre". Kjo shtesë të pasqyrohet edhe në Rregulloren e Brendshme të UV-së.
2. Kjo mënyrë korrigjimi do të jetë alternative dhe do të zbatohet për ato lëndë dhe module sipas miratimit në Departamentet përkatëse.
3. Ngarkohet për zbatimin e këtij vendimi Zëvendësrektori Akademik, Drejtuesit e Njësive Kryesore si dhe Drejtuesit e Njësive Bazë në UV.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI I SENATIT AKADEMIK  
Prof.Dr. Roland ZISI





*Brunilob Gjo*

REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
UNIVERSITETI 'ISMAIL QEMALI' VLORE  
REKTORATI

Nr. 878 / Prot.  
3

Vlorë, më, 26.04.2023

**VENDIM**

Nr. 6, datë 24.04.2023

**PËR**

**MIRATIMIN E KORRIGJIMIT TË PROVIMEVE ON-LINE**


Mbështetur në nenin 40 të Ligjit Nr. 80/2015 "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë", nenin 26 të Statutit të Universitetit "Ismail Qemali", Vlorë, në propozimin e Zv. Rektorit për Kërkim Shkencor dhe Zhvillim Institucional, Nr. 733/2, prot datë 24.04.2023, Rektorati në mbledhjen e tij të dates 24.04.2023,

**VENDOSI**

1. Të miratojë përcjelljen në SA, për shqyrtim dhe miratim të propozimit: "Në pikën 4 të studenteve, në tentat dhe modulet e përcaktuara dhe miratuara prej tyre.
2. Kjo formë vlerësimi i përgjigjeve me shkrim të studentëve të pasqyrohet në sillabuset përkatëse të lëndëve ose moduleve.
3. Ngarkohen për zbatimin e këtij vendimi: Njësitë Kryesore, Njësitë Bazë dhe Drejtoria e Edukimit.
4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**REKTORI**

Prof. Dr. Roland Vizi





REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI 'ISMAIL QEMALI' VLORË

ZV. REKTORI PËR KËRKIMIN SHKENCOR DHE ZHVILLIMIN INSTITUCIONAL

Nr. 733 / Prot. 2  
LORE  
UNIVERSITETI 'ISMAIL QEMALI'

Vlorë, më 24/04/2023

Lënda: Propozim për korrëgjimin e provimeve on-line.

PROF. DR. ROLAND ZISI  
REKTOR

KËTU

I nderuar z. Rektor,

Në kuadër të marrveshjes së Universitetit "Ismael Qemali" Vlorë me Albanian-American Development Foundation (AADF) miratuar me Vendim të Senatit Akademik Nr. 15 datë 31.03.2022, Nr. 479/2 Prot. datë 06.04.2022 "Për miratimin e nënshkrimit të marrveshjes së bashkëpunimit midis Universitetit "Ismael Qemali" Vlorë dhe Albanian American Development Foundation (AADF), në UV ka filluar implementimi i projektit CleanScore. Në zbatim të këtij projekti dhe në bazë të neneve 3.2.4 dhe 3.2.5 të marrveshjes së sipërcituar, UV do të mundësoj "... procedurën alternative të korrëgjimit të provimeve nëpërmjet përdorimit të sistemit të integruar teknologjik të CleanScore në vlerësimin e studentëve..." si dhe "...mundëson angazhimin e

pjesa e pedagogëve të cilët dëshirojnë të përdorin këtë mënyrë alternative, propozoj një vendimarrje të tillë.

Propozoj që kjo vendimarrje mos të jetë detyruese për të ofrohet si opcion alternativ për stafin akademik.

Duke Ju falenderuar për bashkëpunimin!

Zv. REKTOR

Prof. Asoc. Enkelejd Mëhilli